



Paqja e Ndërsjelltë

Udhëzues

Hyrje

Tre shtete. Gjashtë kombësi. Një film.

Paqja e Ndërsjelltë eksploron se si miqësitë e pamundura mund të zene rrënjë dhe të vazhdojnë të rriten. Ne takohemi me tre evropianë që janë përballuar me njerëz të zhvendosur që kanë ardhur në vendin dhe jetën e tyre. Gjithashtu, ne takohemi me njerëz që kanë udhëtuar mijëra kilometra për të kërkuar strehë në Evropë. Këto janë miqësi që u rriten pavarësisht nga diferencat e mëdha.

Filmi i shkurtër paraqet tre marrëdhënie të vërteta, megjithëse ato nuk janë domosdoshmërisht modele për t'u kopjuar pasi çdo miqësi është unike. Ne shpresojmë që duke parë këtë film, ju do të keni mundësi për reflektime dhe diskutime të sinqerta rreth ceshtjes se cilat janë ndjenjat që kemi për njerëzit e zhvendosur në komunitetet tona. Ne kemi krijuar këtë udhëzues diskutimi për të ndihmuar me bisedën.

Shqyrtimi i azilkërkuesve përmes lenteve të ndryshme të politikës, nevojës humanitare, problemeve ekonomike apo shqetësimeve të sigurisë është i vlefshëm. Ky film ju fton të vendosni një lente të re: marrëdhëniet. Ai zbulon mrekullinë e miqësisë që shtrihet përtej ndryshimeve të mëdha mes njerëzve. Paqja e ndërsjelltë është një mundësi për të "takuar" njerëz të vërtetë, si evropianë ashtu dhe ata që kulturat tona i quajnë 'të huaj' dhe të sfidohemi nga mënyra se si ne mund të jemi fqinj me njëri tjetrin pavarësisht nga barrierat e ndryshme.

Qëllimi i këtij projekti është më i madh se një film i thjeshtë. Ne shpresojmë që kishat apo studentët dhe grupet e komunitetit do të krijojnë mundësi për njerëzit të shikojnë filmin dhe më pas të shkojnë një hap më tej. Projekti parashikon që ju qellimisht të siguron një hapësirë të sigurt ku njerëzit mund të reagojnë me sinqeritet ndaj përmbajtjes së filmit përmes ndarjes së përvojave, shpresave dhe shqetësimeve. Ju do të gjeni disa materiale në këtë faqe (<https://www.europeana.org/peace-between-dialogue/>) që mund t'ju ndihmojnë për të krijuar një hapësirë të sigurt ku njerëzit mund të ndajnë reagimet e tyre,



edhe pse shumë të ndryshme nga njëra-tjetra, për të diskutuar lirisht dhe për të dëgjuar qellimisht njëri-tjetrin.

Përmbajtja e udhëzuesit të diskutimit

Udhëzuesi përmbanë pyetje për të ndihmuar dhe lehtësuar diskutimin. Gjithashtu, përmban një sasi të vogël informacioni për secilën nga miqësitë. Për të patur materiale shpesh për diskutim, veprim, mësim, studim biblik dhe lutje, ose për të mbështetur shërbesën e kishës për njerëzit e zhvendosur, ju lutemi vizitoni <https://www.europeanea.org/peace-between-dialogue/>.

Pyetjet në këtë Udhëzues janë të organizuara në mënyrë që ju:

- të diskutoni të tre miqësitë, nëse vendosni të shikoni filmin e plotë.
- të përqëndroheni vetëm në një miqësi, duke shfaqur atë pjesë të filmit që ju intereson dhe të diskutoni për çështjet që kanë të bëjnë me atë miqësi.
- të krijojnë një seri prej tre diskutimeve, duke parë një miqësi për çdo takim dhe duke përdorur pyetjet në lidhje me atë pjesë që keni parë.

Shpjegime të mëtejshme:

- Materiali ka një listë me shumë pyetje. Ju lutemi të zgjidhni vetëm ato që janë më të përshtatshme për kontekstin tuaj.
- Shumica e pyetjeve janë përshtatur qellimisht për persona që nuk kanë domosdoshmërisht një besim të krishterë. Në këtë mënyrë ju mund t'i shfaqni filmin një komuniteti më të gjerë dhe të jepni një mundësi për reflektim.
- Ne gjithashtu rekomandojmë që udhëheqësi i diskutimit të lexojë pjesën e materialeve rreth sfondit të filmit përpara takimit.



Këshilla për një diskutim të suksesshëm të Paqja e Ndërsjelltë

Çështjet e migrimit dhe zhvendosjes mund të jenë të diskutueshme. Disa njerëz janë të interesuar në këto diskutime. Disa njerëz dëshirojnë të ndihmojnë dhe disa të tjerë mund të jenë miqësuar tashmë me një person të zhvendosur. Disa njerëz janë të shqetësuar. Filmi “Paqja e ndërsjelltë” dhe materialet e tij janë projektuar në mënyrë të tillë që çdo njeri të mund t'i shqyrtojë këto çështje në mënyrë të hapur.

Për të patur një eksperiencë pozitive në takimin e diskutimit, ju rekomandojmë që të merrni parasysh hapat e mëposhtëm.

1. Lutje. Nëse prisni që të keni pjesëmarrës me perspektiva të ndryshme në takim lutuni në mënyrë specifike për paqen.
2. Reklamoni ngjarjen si një mundësi për të reflektuar dhe për të ndarë atë që mendojmë dhe ndejme rreth këtyre çështjeve.
3. Në fillim të takimit vendosni rregulla për dëgjim dhe mosmarrëveshje. Përgatisni pjesëmarrësit të vijnë si dëgjues. Inkurajoni ata të respektojnë njëri-tjetrin, madje edhe kur pikëpamjet e tyre ndryshojnë nga njëri-tjetri. Sigurohuni që diskutimi të mos mbizotërohet vetëm nga disa persona.
4. Shmanguni diskutimeve ose pikepamjeve politike.
5. Familjarizohuni me Udhëzimet e Diskutimeve dhe informacionin përkatës përpara takimit. Ju mund të aksesoni materiale plotësuese në <https://www.europeanea.org/peace-between-dialogue/> dhe të zgjidhni ato që mendoni se do të jenë më të përshtatshme për auditorin tuaj.
6. Konsideroni të ftoni një person të zhvendosur në grupin e diskutimit nëse besoni se kjo do të ndihmojë për të stimuluar një bisedë të hapur dhe jo për të dekurajuar atë.
7. Nëse është e qartë se të gjithë pjesëmarrësit e takimit janë të hapur të eksplorojnë idenë e një miqësie me dikë që është zhvendosur, atëherë përqendrohuni tek pyetjet dhe materialet perkatëse me këtë aspekt.
8. Lejoni që shqetësimet mbi migracionin, azilkërkimin, refugjatët dhe personat e zhvendosur të shprehen në takim. Megjithatë, mos lejoni që biseda të kthehet në debat politik. Vazhdoni të përqendrohuni tek tema nëse një kishë ose komunitet mund të ofrojë miqësi.
9. Mbylleni takimin me një fjalë paqësore. Kini parasysh kohëzgjatjen dhe mbylleni takimin me një notë pozitive. Lejoni kohë për të përmbledhur bisedën dhe për t'u lutur.
10. Konsideroni të ofroni pije freskuese në fund të takimit në mënyrë që të lini hapësirë për biseda individuale mes të ftuarve.



Shënim

Në këtë udhëzues diskutimi për dokumentarin "Paqja e ndërsjelltë", ju do të gjeni shumë pyetje si për tre filmat së bashku ashtu dhe për episodet individuale. Ne nuk presim që ju të diskutoni të gjitha këto pyetje, por ne besojmë se ju do të zgjidhni pyetjet që i përshtaten më mirë situatës/audiencës tuaj. Mos ngurroni të shtoni pyetjet tuaja për të nxitur një bisedë të sinqertë dhe të balancuar mbi njerëzit e zhvendosur. Ne do të jemi mëse të lumtur të konsiderojmë t'i shtojmë këto pyetje në udhëzimet e botimeve të ardhshme

Pyetje të përgjithshme për ata që shohin filmin e tre miqësive

Pyetje të thjeshta për hapjen e diskutimit

- Cfarë ju bëri përshtypje ose ju befasoi më shumë në këto tre histori? Pse?
- Cila histori ju preku më shumë? Pse?
- Me cilin karakter e patët më të lehtë për t'u raportuar? Pse?
- Me cilin karakter e patët më të vështirë për t'u raportuar? Pse?

Dy fjale mbi terminologjinë

Njerëzit mund të jenë emigrantë, azilkërkues ose refugjatë. Në këtë studim ne përgjithësisht përdorim shprehjen person ose njeri "i zhvendosur" duke përfshirë secilin nga këto grupe dhe për të theksuar se ata janë larguar nga shtëpia e tyre në një vend të huaj.

Pyetje

- Kush ka takuar një person të zhvendosur? Shpjego pervojen tënde.
- Si mendoni, një person i zhvendosur mund të jetë i ngjashëm me ne apo ndryshe nga ne?
- A mund të imagjinoni situata që do t'ju bënin të ikni nga vendi juaj? Cilat situata do të ishin këto ?
- Nëse do ju duhej të ikni nga vendi juaj, çfarë do t'ju mungonte më shumë?

- Nëse duhej të iknit nga vendi juaj, çfarë do t'ju nevojitej më shumë nga shteti i ri pritës dhe nga njerëzit e tij?
- What concerns us about displaced people? Çfarë na shqetëson më shumë në lidhje me njerëzit e zhvendosur?
- István, Anna dhe Sophie nuk mendojnë për sfidat politike apo sfida të tjera në lidhje me njerëzit e zhvendosur. Ata thjesht po krijojnë miqësi me individë. Pse mendoni që ndodh kjo? Çfarë mendoni për këtë pikëpamje?
- Të gjitha këto miqësi lidhin një ose disa ndryshime (të besimit, moshës, kulturës apo përkatësisë etnike). A keni miqësi që i kalojnë kufij të tilla? Mund të tregoni se cilat janë disa nga bukuritë e këtyre marrëdhënieve dhe sfidat e tyre ?

Mendime më të thella

- Cili mendoni se është roli i qeverisë për t'iu përgjigjur nevojave të personave të zhvendosur? Cili mendoni se është roli i Kishës në përgjigje ndaj nevojave të njerëzve të zhvendosur?
- Sa besim ose mosbesim keni ndaj njerëzve të zhvendosur? Nga vjen kjo ndjenjë?
- Bibla vazhdimisht urdhëron që njerëzit e Perëndisë të ofrojnë mikpritje ndaj të huajit, të kujdesen për të huajt dhe t'i mirëpresin ata që duan të integrohen. (P.sh. Levitiku 19: 34. Mateu 25: 35-45 Shih shënimet plotësuese mbi atë që thotë Bibla mbi përgjegjësitë e të huajve dhe të komunitetit pritës.) Çfarë do të thotë kjo për ne? Çfarë do të thotë kjo për vendin tonë?
- Nëse do të konsideronit të bënit miqësi me një person të zhvendosur, cilat do të ishin motivet tuaja për ta bërë këtë (ose jo)?

Sugjerime për lutje

- Si do të dëshironit të luteshit për veten tuaj dhe për komunitetin tuaj kur behet fjale për njerëzit e zhvendosur në kombin tuaj ose ata që dëshirojnë të vijnë në vendin tuaj?
- Si do të dëshironit të luteshit në mënyrë specifike për personat e zhvendosur?



Më poshtë do të gjeni tre seksione, secili i fokusuar në njëren nga miqësitë. Zgjidhni për të diskutuar miqësinë që duket më interesante për ju. Zgjidhni pyetjet që janë më të përshtatshme.

István dhe Raza, Hungari

István është një drejtues i zellshëm dhe udhëheqës i Aleancës Ungjillore në Hungari. Puna e tij përfshin takimin e sa shumë refugjatëve. Raza është akoma duke u rikuperuar nga trauma e udhëtimit të tij në Hungari si një minoren i pashoqëruar. Ai është duke u përpjekur të përshtatet me jetën hungareze dhe të përfundojë arsimimin e tij. Historia e István dhe Razas na mëson se është e mundur që dy njerëz shumë të ndryshëm dhe të zënë të bëhen miq.

Informacione mbi rrethanat

Fëmijët e pashoqëruar dhe të ndarë: Ka një shumë arsye që fëmijët dhe të rinjtë nga Afrika, Azia Jugore dhe Lindja e Mesme shkojnë në Evropë. Disa ikin nga persekutimi, të tjerë ikin pasi shtëpitë e tyre janë shkatërruar nga lufta, dhe të tjerët janë të dëshpëruar për të jetuar diku ku mund të arsimohen ose të fitojnë një jetesë për të mbështetur familjen e tyre. Ata vijnë si azilkërkues dhe shpresojnë që t'u jepet e drejta dhe mundësia për të qëndruar dhe për të rindërtuar jetën e tyre. Shumë prej tyre janë nën moshën 18 vjeçare dhe mes tyre ka të rinj që udhëtojnë pa familje për muaj apo edhe vite me rradhe. Këta quhen fëmijë të pashoqëruar dhe të ndarë (UASC) ose fëmijë të pa pashoqëruar që kërkojnë azil.

Që nga viti 2013, më shumë se 300,000 fëmijë dhe të rinj të pashoqëruar dhe të ndarë kanë aplikuar për azil në Evropë¹. Shumë prej tyre kanë udhëtuar nëpër kontinent, ndërsa të tjerë mbeten në vendin ku mbërritën për herë të parë. Në shumë raste, këta të rinj kanë qenë pa familje prej muajsh apo edhe vitesh, jetojnë në kushte të mjerueshme, janë pre e trafikantëve, kontrabandistëve dhe ekstremistëve radikalë dhe ekzistojnë në një gjendje harresë – duke mos ditur se kur apo nëse do të marrin azil ose të bashkohen me familjen.

¹ <https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tps00194/default/table?lang=en>

Pyetje

- Duke treguar në platin në dorën e Razës, István thote se Raza ka shumë vlera brenda tij. Çfarë vlerash të tjera vlerësoni tek Raza?
- Vendoseni veten në vendin e István. Çfarë kërcënimi mund të sjelle Raza dhe pse?
- Vendoseni veten në vendin e Razës. Çfarë kërcënimi mund të sjelle Istvan dhe pse?
- István dhe Raza kanë besime, mosha, kultura dhe etni të ndryshme. Ata duket se ia kalojnë mirë me njëri-tjetrin. A keni miqësi që i tejkalojnë kufij të tille? A mund të ndani me ne disa nga bukuritë dhe sfidat e këtyre miqësive?
- Ne mund të mos jemi në gjendje të shpëtojmë botën dhe të zgjidhim të gjitha sfidat që lindin me migracionin, por, sipas István, mund të jemi në gjendje të shpëtojmë një e nga një yjet e detit. Çfarë ndryshimi mendoni se Istvan po bën tek ky i ri, Raza?
- Raza është duke mësuar hungarishten dhe po vazhdon me studimet e tij. Çfarë mund të bëjë István dhe të tjerët për ta ndihmuar Razan në mënyrë që të vazhdojë të integrohet?

Ky seksion përmban një fokus të shkurtër mbi të rinjtë e zhvendosur dhe të pashoqëruar. Duke patur në mendje se si Raza dhe vëllai i tij u larguan nga shtëpia e tyre si adoleshentë dhe jetuan për më shumë se një vit nën një urë në Greqi, diskutoni këto pyetje:

- Cilat situata mund të kenë shtyrë Razan dhe vëllain e tij për të bërë këtë udhëtim pa prindërit e tyre?
- Si mund që ndjehen prindërit e tyre për ndarjen e tyre? Nëse jeni prind, si do të ndjeheshit nëse fëmija juaj duhej të largohej nga shtëpi pa ju?
- Çfarë mendoni i ndihmoi ata të mbijetonin gjatë gjithë kësaj kohe?
- Si mund të ndikojë kjo në të ardhmen e tyre?
- Si mund të ndikojë një mik si István në jetën e tyre?
- Çfarë lloj ndihme dhe shprese mund të ofrojnë njerëzit nga Kisha të rinjve në situata të tilla?

Mendime më të thella

- Sa besim ose mosbesim keni ndaj të huajve? Sa i besueshëm mendoni se është baza juaj për këtë besim apo mosbesim?
- Dhjata e Vjetër supozon se të huajt do të integrohen dhe do t'i përmbahen ligjeve të Izraelit, duke përfshirë edhe ato fetare. Si përshtatet ky parim me personat e zhvendosur në vendin tuaj? Çfarë mendoni se duhet (ose nuk duhet) të ndodhë?
- Si mund t'i ndihmojmë njerëzit e zhvendosur me besime të tjera të integrohen në shoqëritë tona?



Anna dhe Dana, Kopenhagen

Ana është një vajzë e re tipike daneze që jeton në Kopenhagen. Dana, nga Siria, është ende e traumatizuar nga tmerrri i luftës që ajo ka përjetuar. Ajo është bashkë me familjen e saj, por tregon sesa e mrekullueshme është që ka një mike si Anna, dikush që nuk i përket kujtimeve të luftës; Anna është si një motër më e madhe. Ato ndajnë trishtimet e tyre, por gjithashtu të gjitha gjërat normale që gëzojnë dy vajza të reja. Familja e Annës nuk jeton afër, dhe familja e Danës është e kënaqur ta përfshijë atë në jetën e tyre familjare.

Informacione mbi rrethanat

Disa këshilla nëse dëshironi të bëni miqësi me një person të zhvendosur

- I thirrni ata **"miku im"** dhe jo **"miku im refugjat"**. Ata janë persona individual me ndjenja, shpresa dhe ëndrra të ngjashme me ato që ju përjetoni.
- **Jini vazhdimisht të pranishëm dhe të disponueshëm**. Mbani mend nevojën e tyre për qëndrueshmëri dhe stabilitet. Angazhohini me një person ose një familje dhe zhvilloni marrëdhënie të qëndrueshme me ta.
- **Jini të gatshëm të dëgjoni dhe të kuptoni perspektivën e një personi tjetër**. Mbani mend se mënyra e tyre për të kuptuar besimin, politikën etj., mund të jete e ndryshme nga ju. Dëgjoni. Mos u mundoni të ndryshoni pikëpamjet e tyre.
- **Dëgjoni mirë, pa ofruar zgjidhje të thjeshta ose të shpejta**. Mos supozoni që ju dini se çfarë është më e mira për ta.
- **Prezantohini ata me persona të tjerë të sigurtë**. Lidhini ata me persona të tjerë që mund t'i ndihmojnë të integrohen në komunitet (p.sh. gjejnë punë, të takohen me prindërit e tjerë në shkollë, të takohen me fqinjët). Ndhimohini ata të kuptojnë rutinën e komunitetit.
- **Lejoni që ata të shprehin frikë dhe zemërim pa i gjykuar**. Ata mund të kenë ndjenja negative ndaj situatës që kanë lënë ose gjendjes aktuale në vendin tuaj. Shoku kulturor është një pjesë normale e procesit. Dëgjoni. Kuptoni kur është e nevojshme që t'i ftoni ata të takohen me një terapist apo psikolog. Ndhimohini që ata të krijojnë keto lidhje.
- **Lejoni që ata të bëjnë pyetje frymërore pa e ndjere të nevojshme që t'i jepni një përgjigje**. Shmanguni nga ndejnja për t'i shtyrë që ata të bëhen të krishterë. Kuptoni se disa pyetje "pse" nuk kanë përgjigje të lehta. Jini të pranishëm dhe të dhembshur.

- **Mos bëni premtime që e dini që nuk mund t'i mbani apo që nuk keni mundësi t'i mbani.** Disa rezultate si viza, ligje, dhe procese migracioni nuk varen nga ju. Bëni premtime që do të bëni diçka vetëm në ato raste që keni mundësi dhe ndërmend të bëni diçka.
- **Kur të dëgjoni historinë e tyre tregoni ndjeshmëri.** Nëse ata kanë përjetuar trauma, përgjigja juaj empatike e pranon dhe e njeh dhimbjen e tyre. Ju ndjejeni dhimbjen e tyre, njiheni atë dhe reagoni me dhembshuri.
- **Respektoni kufijtë e tyre.** Për disa njerëz, te treguarit e historise se tyre disa here është pjesë e procesit të shërimit të tyre. Për të tjerët, kujtimet janë shumë të dhimbshme për t'u ndarë me të tjerët, të paktën për momentin. Respektoni zgjedhjen e personit.
- **Pranojeni se dhe ata ofrojnë diçka që ju keni nevojë; tregohuni te përvullur dhe pranojeni atë.** Përvoja e tyre jetësore, perspektiva botërore dhe aftësitë e tyre janë po aq të vlefshme sa dhe juaja. Mësoni të jeni mjaft të përvullur për të njohur nevojën tuaj dhe të jeni të gatshëm të pranoni dhe kërkonte ndihmën e tyre.

Pyetje

- Meqenese familja e Annës është larg, ajo është mirëpritur në familjen e Danës. Si e ndihmoi Danën miqësia e Anës? Pse kjo miqësi është e rëndësishme për të?
- Sa e rëndësishme është familja juaj për ju? A mund të funksiononit pa të?
- Anna përmend disa ndryshime në kulturën familjare. Çfarë ndryshimesh keni vëzhguar? Si mund të ndihet Dana dhe familja e saj për këto dallime?
- Çfarë mendoni se Dana / Anna vlerëson në miqësinë e tyre?
- Kujtimet e Danës ende shkaktojnë dhimbjen të madhe. Çfarë historish keni dëgjuar për traumat që azilkërkuesit kanë kaluar?
- Çfarë mund të ndihmojë njerëzit që të shërohen nga trauma?
(Shih <https://www.europeana.org/peace-between-dialogue/> për më shumë informacione dhe ide).

Mendime më të thella

- Familja e Danës e mirëpriti Annën si motrën më të madhe në familje. A do të jeni të gatshëm dhe/ose të aftë të bëni të njëjtën gjë me një person të zhvendosur që jeton pranë jush? Pse po ose pse jo?
- Anna thekson se si familja e saj dhe familja e Danës praktikojnë mikpritjen ndryshe. Shpesh një azilkërkues/refugjat dëshiron të ofrojë mikpritje, por ftesa ose ushqimi mund të jetë ndryshe nga ajo që ju jeni mësuar. Si ndiheni për këtë? Nëse ju do të ofroni mikpritje për një refugjat, çfarë mendoni se duhet të keni parasysh? A do të ishit në gjendje të pranoni mikpritjen nga një fqinj refugjat? Si mendoni se do të ndikojë kjo tek ju?



Yonathan dhe Sophie, Brest

Yonathan dhe Meron janë azilkërkues të krishterë nga Etiopia. Ata u takuan në kampin "Jungle" në Calais në veri të Francës dhe tani kanë një fëmijë. Sophie, nga jugu i Francës, gjithashtu një e krishterë, u prek thellësisht nga mirësjellja që ata i ofruan asaj në ashpërsinë e kampit dhe gëzimin e tyre në adhurim. Yonathan, Meron dhe fëmija i tyre tani janë në Brest, Veriperëndim të Francës, duke pritur për të dëgjuar nëse ata mund të qëndrojnë në këtë vend. Të ndarë nga familjet e tyre, ata çmojnë miqësinë e tyre të vazhdueshme me Sophien.

Informacione mbi rrethanat

Natyrisht që ka shumë të krishterë në mes të njerëzve të zhvendosur që kanë ardhur në Evropë. Shumë ishin të krishterë kur u larguan nga shtëpitë e tyre, të tjerë janë kthyer të krishterë në udhëtim. Organizatat e krishtera që punojnë me njerëz të zhvendosur thonë se po ndodh një lëvizje e jashtëzakonshme e Perëndisë.

Të krishterët mund të jenë veçanërisht të cenueshëm në kampet dhe qendrat e pritjes për shkak të besimit të tyre. Ata kanë nevojë për mbrojtje dhe njerëz që i përkrahin ata. Ata gjithashtu dëshirojnë miqësi me Kishën lokale dhe një ndjenjë përkatësie me vëllezërit dhe motrat e kishës lokale. Në këto menyre, dhe sidomos me mbështetjen dhe inkurajimin e Kishës lokale, ato mund të jenë dëshmitarë të mëdhenj brenda komunitetit të azilkërkuesve.

Nëse krahasoni vendet për persekutimin e krishterë më të keq me kombësitë e personave të zhvendosur në Europë, do të vini re një korrelacion të trishtuar. Nuk është ekzagjerim të thuhet se nëse të krishterët deportohen në disa prej këtyre vendeve, ata do të jenë në rrezik të madh.

A duhet të favorizojmë azilkërkuesit e krishterë mbi të tjerët kur bëhet fjalë për zgjedhjen se kujt do t'i jepet e drejta për të qëndruar përgjithmonë? Udhëheqësit e Kishës siriane thonë me një zë të lartë dhe të qartë "Jo!". Ata janë të tronditur me mendimin që mësimi i Jezusit për Samaritanin e Mirë mund të harrohet. Të krishterët mund të jenë më në rrezik dhe ne duhet të reagojmë në përputhje me rrethanat e realiteti. Por azili duhet të jepet vetëm në bazë të nevojës individuale.

Për më shumë informacione mbi rrethanat e njerëzve të zhvendosur të krishterë, ju lutemi referojuni <https://www.europeanea.org/peace-between-dialogue/>.

Pyetje

- A keni takuar apo dëgjuar ndonjëherë për refugjatët e krishterë? Tregoni për këtë. Si është kultura fetare dhe praktika e tyre, e ngjashme apo e ndryshme nga e jona ?
- A keni takuar apo dëgjuar ndonjëherë për refugjatë të besimeve të tjera që janë bërë të krishterë? Si ka ndikuar kjo në jetën e tyre?
- Yonathan kishte ecur nëpër peisazhin e ashpër të shkretëtirës, u kap nga një kamion, kaloi Mesdheun në një varkë dhe, për pesë ditë ishte përpjekur të kalonte detin për të shkuar në Britaninë e Madhe. Çfarë tregimesh të tjera të udhëtimeve të vështira të refugjatëve keni dëgjuar? Çfarë i motivon njerëzit që të marrin këto rreziqe?
- Yonathan shkon dy herë në javë në qendrën e pritjes së refugjatëve për të parë nëse është marrë vendimi për ta lejuar atë të qëndrojë në Francë. Çfarë ndjesie duhet të jetë të presësh për disa vjet për të zbuluar më së fundi nëse do të qëndrosh ose do të deportohesh ?
- Yonathan dhe Meron dëshirojnë të qëndrojnë në Francë sepse perparësia e tyre është "jeta shoqërore", me anë të së cilës ata nënkuptojnë bashkësinë e tyre të miqve, familjen e Kishës etj. Kur një refugjat ka humbur familjen, identitetin, vendin, gjithçka, sa e rëndësishme duhet të jetë për të të ndjeje se është i vlerësuar nga një komunitet dhe një ndjenjë e një familje të zgjeruar?
- Si mund t'i ndihmoni njerëzit të ndihen si "në shtëpinë e tyre" në vendin tuaj?

Mendime më të thella

- Yonathani dhe Meroni duket se kanë gjetur vendin e tyre në një kishë lokale. Deri në çfarë mase është komuniteti apo kisha juaj e hapur për refugjatët? Çfarë mund të bëni për (më tej) ta përmirësuar këtë?
- A është e rëndësishme që Yonathan dhe Meron të jenë të krishterë? A i ndihmon ata më shumë të integrohen në Francë, i cili konsiderohet vend i krishterë?
- Nëse jeni të detyruar të largoheni nga shtëpia dhe vendi juaj dhe të shkoni në një kontinent të ri, si mendoni se njerëzit e vendit pritës mund t'ju përgjigjen juve? Si do të shpresonit që të krishterët e këtij vendi pritës do t'ju përgjigjeshin juve?
- Duke marrë parasysh përgjigjet e pyetjes së mësipërme, cilat janë disa reflektime mbi këtë varg: "Kur një i huaj banon bashkë me ju në vendin tuaj, mos e trajtoni keq. Të huajin që banon midis jush ta trajtoni njëllë si ai që ka lindur midis jush; ti do ta duash si veten tënde, sepse edhe ju ishit të huaj në vendin e Egjiptit. Unë jam Zoti, Perëndia juaj." Levitiku 19: 33-34.

Tre vende. Gjashtë kombësi. Një film. Dhe sfidat që takohen për të gjetur paqen që mund të ekzistojë mes nesh. Qoftë ky projekt një lente për të parë anën njerëzore të krizës së refugjatëve dhe për të na drejtuar të gjithëve drejt paqes.

Shikoni <https://www.europeana.org/peace-between-dialogue/> për detaje mbi drejtuesit e këtij filmi si dhe krijuesve të këtyre materialeve